



DATA/DATUM/DATE	14.01.2022
NR/ BR	07 Nr./ <u>19</u>
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për personel teknik
PËRMES/PREKO/THROUGH	Sektorit të administratës së Drejtorisë së Arsimit
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z.Afrim Llabjani
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Konkurs për pastrues në shkolla

Bazuar në nenin 08 të Ligjit të Punës 03/L-212, nenin 37 paragrafi 2 dhe 4 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-32, neni 5 pika c, i Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Drejtoria e Arsimit në Ferizaj shpall:

KONKURS

Për vende të lira të punës për personel teknik:

Në Shkollën e Mjekësisë "Elena Gjika" në Ferizaj.
Një pastrues/e.

Në SH.F.M.U. në Fshatin Tërrn, Komuna e Ferizajt,
Një pastrues/e .

Detyrat e punës: Kujdeset për pastrimin dhe mirëmbajtjen e higjienës në institucionin shkollos. Bënë pastrimin e të gjitha lokaleve shkollore, pajisjeve të shkollës si dhe objekteve përcjellëse. Kujdeset për pastrimin dhe mirëmbajtjen e oborrit të shkollës në mbrojtjen e mjedisit dhe kultivimit të gjelbrimit.

Kryen edhe detyra tjera të cilat ia cakton drejtori ose sekretari i shkollës.

Për vendin e punës pastrues kërkohet shkolla e mesme e (preferuar).

Kushtet

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyren për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit.

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:

Kërkesën për punësim.

Diploma ose Çertifikata e shkollës.

Çertifikatën e lindjes

Kopjen e letërnjoftimit

Dëshminë që nuk jeni nën hetime ose në procedurë hetimore.

Kohëzgjatja e kontratës së punës fillon prej datës së fillimit të punës.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.

Dokumentet e aplikimit nuk kthehen.

Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit në tabelën e shpalljeve, web faqen e Komunës dhe në njërin nga mjetet e shkruara të informimit, duke filluar prej datës **14.01.2022** deri më **28.01.2022**.